



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
PRESIDENTI



Nr. 6/1 Prot

Tiranë, më 27.01.2022

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Znj.Arlinda SHELLA  
Znj.Aleksandra PUCI  
Znj.Lorenda BAJOLLARI  
Znj.Redina BALLA  
Znj.Greta TALO  
Znj.Eralda XHAFA  
Znj.Denisa Tanku  
Znj.Ines HAXHIMALI  
Znj.Danjela BLACERI  
Znj.Brunilda LABOVITI  
Znj.Eglantina NIKOLLI  
Znj.Graciela MANE  
Znj.Donika MALIQI  
**Psikologë Anëtarë të Urdhrit të Psikologut**

Të nderuar anëtarë,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 10.01.2022, mbërritur në zyrën tonë datë 14.01.2022, protokolluar me nr.6 Prot, lidhur me *vendimin Nr.17 datë 29.12.2021* të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, për ndryshimin e kuotizacionit vjetor për vitin 2022 për anëtarët e Urdhrit të Psikologut, Ju bëjmë me dije se:

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut në datë 29.12.2021, me anë të vendimit Nr.17, vendosi unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent në mbledhje të miratojë ndryshimin e kuotizacionit vjetor për vitin 2022 sipas kategorive si më poshtë:

- 1.Për të gjithë anëtarët psikologë me statusin e Praktikantit (pra për të gjithë ata që nuk janë të Licencuar), Kuotizacioni Vjetor do të jetë në vlerën 4.500 Lekë.
- 2.Për të gjithë anëtarët psikologë të cilët janë të licencuar dhe që janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë, Kuotizacioni vjetor do të jetë në vlerën 15.000 Lekë.
- 3.Për të gjithë anëtarët e tjerë, të cilët nuk bëjnë pjesë në asnjë prej kategorive të mësipërme vlera e Kuotizacionit vjetor do të ngelet e njëjtë në masën 6.000 Lekë.



Bly.Gjergj Fishta, Ndërtesa nr.26, Kati II, Ap.9, Tiranë,  
email: [sekretaria@urdhriipsikologut.al](mailto:sekretaria@urdhriipsikologut.al), Tel.: 0035544 51 1804



Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Ju se ky vendim është marrë në kushtet e moskonsultimit me grupet e interesit dhe se përbën një shkelje ligjore, sqarojmë se:

Në nenin 16 të Ligjit Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", specifikohet menyra se si organi i Këshillit Kombëtar është formuar dhe detyrat specifike të tij si organ ekzekutiv i Urdhrit të Psikologut. Këshilli Kombëtar është një organ i përbërë nga 17 anëtarë të ndarë sipas fushave të ndryshme, duke bërë kështu që në të të ketë anëtarë përfaqësues nga shumë profile të ndryshme të fushës së psikologjisë.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 17 anëtarë. Anëtarë të Këshillit Kombëtar janë:

- a) Presidenti i Urdhrit;
- b) nga një përfaqësues i ministrive përgjegjëse për arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, mbrojtjen dhe çështjet sociale;
- c) tre pedagogë të psikologjisë, me gradë shkencore Profesor, Prof. i Asociuar dhe Doktor Shkencash, që punojnë në institucione të arsimit të lartë, nga universitetet publike dhe private;
- ç) shtatë psikologë që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie;
- d) një anëtar nga Shoqatat e Psikologëve

Siç mund të kuptohet qartësisht kjo lloj ndarje që ligjvënësi ka menduar sa i përket mënyrës se si ky organ është formuar, është për të patur në të anëtarë, të cilët vijnë nga profile të ndryshme të fushës së psikologjisë. Kjo e bën këtë vendim të pranuar nga shumë psikologë të profileve të ndryshme të psikologjisë, të cilët kanë zgjedhur të kenë këtë grup përfaqësuesish në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

Nga ana tjetër, kategorizimi i kuptacionit është një çështje që diskutohet prej disa vitesh, jo vetëm në Këshillin Kombëtar, por edhe në të gjitha takimet e realizuara nga Urdhri i Psikologut me psikologët në të gjitha rrethet e vendit. Në çdo takim është diskutuar mundësia dhe është shprehur dakordësia dhe qëllimi i përbashkët për të kategorizuar kuotizacionin e anëtarësisë, me synimin për të lehtësuar barrën e psikologëve të rinj, kryesisht praktikantëve, të cilët, siç dihet, hasin vështirësi për t'u integruar në tregun e punës.

Në lidhje me pretendimin se ky vendim i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, përbën shkelje ligjore, po në nenin 16 të këtij ligji (pika 2b), ashtu si edhe në nenin 28 pika 2b) e Statutit të Urdhrit të Psikologut, specifikohen përgjegjësitë që ligji i'a atribuon në mënyrë ekskluzive Këshillit Kombëtar, ku një prej të cilave është edhe **çaktimi i kuotizacionit dhe tarifave**.

Neni 42 i Statutit të Urdhrit të Psikologut specifikon **se i vetmi organ përgjegjës për miratimin e kuotizacionit vjetor** për anëtarët e Urdhrit të Psikologut është Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut. Gjithashtu në këtë nen specifikohet edhe mënyra se si merret ky vendim.

*Kuotizacioni vjetor për anëtarët përcaktohet nga Këshilli Kombëtar në fundvit, në varësi të gjendjes, kërkesave dhe nevojave për të siguruar funksionimin normal të Urdhrit të Psikologut. Propozimi për ndryshimin e kuotizacionit vjetor bëhet me shkrim nga cilido prej anëtarëve dhe duhet të përmbajë analizën e efekteve të pritshme financiare. Vendimi i Këshillit*





*Kombëtar në lidhje me kuotizacionin mund të merret në çdo fundviti, me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, dhe hyn në fuqi në vitin pasardhës financiar. Mosarritja e shumës së cilësuar lë në fuqi kuotizacionin aktual.*

**Nga sa më sipër sqarohet qartësisht se është Këshilli Kombëtar dhe jo Asambleja Kombëtare, sikundër Ju pretendoni, organi i cili ka përgjegjësinë ligjore për miratimin e kuotizacionit vjetor.**

Në lidhje me pretendimin se ky afat kohor nuk përkon me mbylljen e vitit fiskal, sqarojmë se **viti fiskal mbyllet në datë 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik**, ndaj ky vendim është marrë në kohën e duhur, brenda afatit ligjor dhe hyn në fuqi menjëherë në vitin pasardhës, sikundër e specifikon *neni 42 i Statutit të Urdhrit të Psikologut*.

Në lidhje me pretendimin se ky vendim është diskriminues, dëshirojmë të sqarojmë se:

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, nuk kanë marrë vetëm një vendim për ndryshimin e kuotizacionit, e cila është një përgjegjësi që i'a atribuon ligjvënësi, si një vlerë financiare që prek një zë të caktuar në buxhet, por marrja e një vendimi të tillë është një politikë e mirëmenduar me karakter të mirëfilltë social, e cila ka si arsye të vetme dhënien e një ndihmese sado të vogël më shumë se 600 anëtarëve psikologë, të cilët kanë statusin e praktikantit. Kategorizimi i pagesës së kuotizacionit vjetor për anëtarët e Urdhrit të Psikologut, është një vendim që lehtëson koston për ata anëtarë, pjesa me e madhe e të cilëve nuk janë ende të punësuar e janë në pritje të fillimit të Praktikës Profesionale, janë duke e kryer, e kanë përfunduar apo janë përjashtuar nga kryerja e saj, e janë në pritje të marrjes së licencës profesionale, në mënyrë që të kenë mundësi të pavarura për t'u punësuar.

Pra, anëtarët e Këshillit Kombëtar kanë gjykuar se një kategorizim i tillë, jo vetëm që nuk diskriminon askënd, por përkundrazi ndihmon një numër shumë të lartë të anëtarëve, të cilët nuk kanë të njëjtat mundësi si disa anëtarë të tjerë dhe pikërisht për të bërë të mundur që buxheti modest i një insitucioni ende të ri si Urdhrit i Psikologut, të mos preket nga kjo ulje e kuotizacionit për këta anëtarë, por të vijojë të funksionojë normalisht, sikundër specifikohet edhe në nenin 42 të Statutit të Urdhrit të Psikologut, është menduar që kjo ulje e vlerës së kuotizacionit të balancohet me rritjen e kuotizacionit për psikologët, të cilët janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo kategori psikologësh përbëhet prej jo më shumë se 80 psikologë, të cilët zhvillojnë një aktivitet prej të cilit përfitojnë më shumë të ardhura krahasuar me psikologë të tjerë dhe ndaj është gjykuar se pagesa e kuotizacionit prej 15000 Lekë nga këta psikologë, do të jetë një kontribut shumë i rëndësishëm për më shumë se 600 praktikantë dhe mbi të gjitha nuk do të çënojë funksionimin e shëndetshëm të insitucionit tonë, në aspektin financiar.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen Tuaj se një kategorizim i tillë sa i përket pagesave vjetore të anëtarësisë është një praktikë të cilën e hasim si në insitucione brenda vendit po ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Kështu p.sh., Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për vite me rradhë aplikon të njëjtën mënyrë, lidhur me kuotizacionin vjetor që çdo avokat duhet të kryejë në fillim të vitit kalendarik. Një avokat i cili thirrej në procese gjyqësore në gjykatat e shkallëve të para, paguante një kuotë më të ulët krahasuar me avokatët, të cilët përfaqësonin palë në gjykim në gjykatat e Apelit apo edhe në Gjykatë të Lartë. Aktualisht, avokatët me më pak se 5 vjet eksperiencë ose avokatët të cilët kanë mbushur moshën e pensionit, paguajnë kuotizacion më të ulët se kategoria e avokatëve të tjerë. E njëjtë praktikë ndiqet edhe për ekspertët kontabël, të cilët kuotizacionin e kanë të kategorizuar sipas nivelit të kualifikimit.





Një praktikë e tillë ndiqet edhe nga insitucioni më i rëndësishëm në nivel europian sa i përket fushës së psikologjisë, siç është **Shoqata Europiane e Psikologëve, European Federation of Psychologists's Association (EFPA)**. Prej vitit 2019, Urdhri i Psikologut është bërë anëtar me të drejta të plota në këtë shoqatë, së bashku me 37 vende të tjera anëtare, por **pagesa vjetore për anëtarësinë, e cila duhet të shlyhet nga të 38 vendet anëtare të EFPA-s nuk është e njëjtë**, por e ndarë sipas numrit të anëtarëve që ka çdo organizatë dhe mundësive financiare që ato kanë, të ndikuara nga shumë faktorë.

Si përfundim, një praktikë e tillë, pra kategorizimi i kuotizacionit nuk është një politikë diskriminuese, pasi brenda të njëjtës kategori, çdo psikolog paguan të njëjtin kuotizacion. Është në diskrecionin ligjor të Këshillit Kombëtar të zhvillojë politika që synojnë mbrojtjen dhe përkrahjen e psikologëve të rinj nga njëra anë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të organizatës nga ana tjetër.

Në përfundim gjykojmë se Vendimi Nr.17, datë 29.12.2021 i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut për miratimin e kuotizacionit për anëtarë e tij për vitin 2022 sipas kategorizimit, është një **vendim i bazuar në ligj, jo diskriminues dhe mbi të gjitha është një vendim me karakter të mirëfilltë social, që do t'u vijë në ndihmë një numri të lartë të anëtarëve të Urdhrit të Psikologut.**

**Dr.Valbona Treska**  
**Presidente**

